



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2022:277738

Datë: 08.01.2025

Numri i dokumentit: 06691571

2023:018385

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ- DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM-DIVIZIONI PENAL, gjyqtari i vetëm gjykues Imri Sejda, me bashkëpunëtorin profesional Shkelzen Polloviqi, në çështjen penale kundër të pandehurit B.S.nga fsh., për shkak të dyshimit të bazuar se ka kryer veprën penale Kanosja nga neni 181 par.3 lidhur me par.2 të KPRK-së, duke vendosur sipas kërkesës së mbrojtësit me autorizim të pandehurit av.Labinot Buzuku për hedhje të aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj, PP.nr.1917/2022 të dt. 19.01.2023, konform nenit 244 par. nen par.1.7 të KPPK-së, me dt.08.01.2025 merr këtë:

A K T V E N D I M

HUDHET aktakuza e Prokurorisë Themelore në Ferizaj, PP.nr. 1917/2022 e dt. 19.01.2023, dhe PUSHOHET procedura penale ndaj të pandehurit B. I. S. nga, K., i lindur me dt., me nr. personal, për shkak të veprën penale Kanosja nga neni 181 par.3 lidhur me par.2 të KPRK-së, nga se aktakuza është ngritur në kundërshtim me ligjin.

Pala e dëmtuar I. A. S. nga fsh. K....., për realizimin e kërkesës pasurore- juridike, udhëzohet në kontest civil.

Shpenzimet e procedurës paguhen nga mjetet buxhetore të kësaj gjykate.

A r s y e t i m i

Prokuroria Themelore në Ferizaj-Departamenti të përgjithshëm, ka paraqitur aktakuzën, PP/II.nr. 1917/2022 të dt. 19.01.2023, ndaj të pandehurit të lartcekur, për shkak të dyshimit të bazuar se ka kryer veprën penale Kanosja nga neni 181 par.3 lidhur me par.2 të KPRK-së, dhe ka kërkuar që i njëjti të shpallet fajtor dhe të dënohet sipas ligjit.

Shqyrtimi fillestar në këtë çështje penale –juridike është mbajtur me datë 16.10.2023 dhe meqenëse i pandehuri nuk e ka pranuar fajësinë, atëherë gjyqtari i vetëm gjykues, duke u bazuar në nenin 240 par. 7 të KPPRK-së, ka kërkuar nga i pandehuri dhe mbrojtësi i tij, që në afate prej 30 (tridhjetë) ditësh ti paraqesin propozimet për kundërshtim të provave të cekura në aktakuzë dhe të paraqesin çdo kërkesë për hudhje të aktakuzës, të cilat i parasheh ligji.

Mbrojtësi i të pandehurit av.Labinot Buzuku, ka paraqitur kërkesë për hedhje të aktakuzës, me arsyetim se ka bazë të artikulueshme që gjykata të çmojë provën si thellësisht të pamështetshme, se ekzistojnë rrethana të cilat e përjashtojnë përgjegjësin penale dhe se nuk ka prova të mjaftueshme për të mbështetur një dyshim të bazuar mirë se i pandehuri ka kryer veprën penale të ngarkuar në aktakuzë, ngase prokuroria nuk ka argumentuar me prova konkrete me të cilat do të dëshmohej dhe argumentohej dyshimi i bazuar mirë se i pandehuri ka kryer veprën penale të ngarkuar në aktakuzë. Prokuroria ka nxjerr Aktvendim për zhvillim të hetimeve, por ka aplikuar hetime të njëanshme madje në kundërshtim me nenin 9 të KPPRK-së, duke shkel parimin e barazisë së armëve, ka ftuar vetëm të dëmtuarin dhe një zyrtare policore në fazën e hetimeve, ndërsa ka mohuar të drejtën e dëgjimit të pandehurit. I mbrojturi im në shqyrtimin fillestar nuk e ka pranuar fajësinë për veprën penale kanosje nga neni 181 par. 3 lidhur par.2 të KPRK-së, dhe nga përshkrimi i prokurorisë si dhe nga dëgjimi i të dëmtuarit dhe dëshmitares dhe nga gjendja faktike nuk rezulton se është kryer vepra penale nga i pandehuri B. S., ngase nuk janë përmbushur elementet e veprës penale Kanosje, pasi që ai nuk ka kanosur të dëmtuarin I. e as që ka mundur që ky të jetë ndier i frikësuar dhe të ketë qenë në ankth. Prokuroria pa të drejtë e në kundërshtim me provat që ka pasur në dispozicion e që janë deklaratat kontradiktore të palëve ka ngritur aktakuzën ndaj të mbrojturit tim meqë në këtë rast mungon lidhja kauzale në mes të veprimit apo të mos veprimit të B. S. dhe pasojës, pra mungon lidhja shkak –pasojë. Është e qartë se B.S.ka pasur mosmarrëveshje me I. mirëpo i njëjti nuk e ka kërcënuar askënd por I. në momentin kur e kishte parë policinë më saktë policen Drita kishte përdorur fjalën Kanosje që të binte në sy të njëjtëve.

Gjykata me aktvendimin nr. 2023:018385 të dt. 04.12.2023, ka refuzuar si të pabazuar kërkesën e mbrojtësit të pandehurit av.Labinot Buzuku, për hedhje të aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj, Departamenti i përgjithshëm PP/II.nr.1917/23 të dt. 19.01.2023, me arsyetim se ka prova të mjaftueshme dhe së të njëjtat janë të nxjerrura në harmoni me dispozitat e KPP-së dhe se në veprimet e të pandehurit ekzistojnë të gjitha elementet e veprave penale për të cilat është ngarkuar me aktakuzë, për kundërshtim të provave që është kërkuar nga mbrojtësi i të pandehurit se veprimet e të pandehurit paraqesin apo jo vepër penale, poashtu në dispozitiv të aktvendimit nuk është vendosur rrethë mohimit të drejtës së dëgjimit të pandehurit nga prokuroria.

Mbrojtësi i të pandehurit pasi ka pranuar Aktvendimin e sipërpërmendur, në afatin ligjor ka ushtruar ankesë, ndaj aktvendimit të lartcekur të kësaj gjykate.

Gjykata e Apelit të Kosovës, duke vendosur sipas ankesës së mbrojtësit të pandehurit av. Labinot Buzuku, ka aprovuar ankesën e mbrojtësit në fjalë dhe ka anuluar aktvendimin e Gjykatës Themelore në Ferizaj dhe në Aktvendimin e saj PN.nr. 283/24 të dt. 23.02.2024, ka udhëzuar Gjykatë e shkallës së parë që ti mënjanojë shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale që janë bërë në rastin konkret, siç është mohimi i të drejtës së dëgjimit të pandehurit gjatë zhvillimit të hetimeve nga prokurori i shtetit dhe në rivendosje ka kërkuar që gjykata të kujdeset për atë se a është zbatuar dispozita ligjore e nenit 149 të KPPRK-së nga prokuroria.

Gjykata duke vepruar sipas udhëzimeve të Gjykatës së Apelit të Kosovës, fillimisht i ka dërguar një kopje të këtij aktvendimi të Gjykatës së Apelit PN.nr. 283/24 të dt. 23.02.2024 Prokurorisë Themelore në Ferizaj- prokurores së rastit Mimoza Sylja Hyseni dhe ka kërkuar të sqarohet se a është marruar në pyetje i pandehuri nga prokuroria gjatë fazës së hetimeve. Prokuroria, Prokurorja në fjalë përmes imailit zyrtarë me dt. 10.09.2024, i ka kthyer përgjigjen gjykatës në të cilën përgjigje ka theksuar se aktakuza PP/II.nr.1917/22 e datës 19.01.2023, ndaj të pandehurit është ngritur para se të hy në fuqi Kodi i ri i procedurës penale nr.08/L-032, ndërsa Gjykata e Apelit të Kosovës iu ka referua nenit 149 par.1. të kodit të ri penal, Rrjedhimisht kjo aktakuzë është ngritur me ligjin e vjetër që ka qenë në fuqi para ngritjes së kësaj aktakuze dhe është ngritur konform dispozitave ligjore dhe nuk ka asnjë shkelje ligjore.

Gjyqtari i vetëm gjykues duke vepruar sipas udhëzimeve të Gjykatës së Apelit të Kosovës, ka analizuar edhe një herë aktakuzën e shkresat tjera të lëndës, kërkesën e mbrojtësit për hudhje të aktakuzës e edhe përgjigjen e prokurorisë- prokurores së rastit dhe pas këtyre analizimeve ka konstatuar se duhet të hudhet aktakuza dhe të pushohet procedura penale ndaj të pandehuri, ngase aktakuza ndaj tij është ngritur me shkelje të dispozitave ligjore dhe në kundërshtim me ligjin, gjegjësisht të nenit 151 par.1 të KPPRK-së, nr.04/L-123, (kodi penal i vjetre), në të cilin thuhet se para ngritjes së aktakuzës i pandehuri merret në pyetje në seancën e marrjes së deklaratës nga prokuroria, në rastet kur për veprë penale me ligj është parapa dënimi maksimal mbi tri vite burgim, e që në rastin konkret nuk është përfillur kjo dispozitë ligjore nga prokuroria edhe pse ka qenë e obligueshme pasi që për të pandehurin është ngritur aktakuzë për veprë penale për të cilën parashihet dënim nga 6 muaj deri 5 vite burgim dhe nga mos zbatimi i dispozitës ligjore të sipërpërmendur të pandehurit i është shkelur e drejta në mbrojtje nga ana e prokurorisë pasi i pandehuri nuk është marr në pyetje nga prokuroria në procedurë paraprake si dhe nuk i është dhënë mundësia e kundërshtimit të provave gjatë fazës së hetimeve, siç është paraparë dhe garantuar me nenin e lartcekur- neni 151 par. 1 të Kodit e procedurës penal të Republikës së Kosovës nr. 04/L-123 (kodi penal i vjetre) e që kjo është paraparë edhe tani në nenin 149 kodin e procedurës penale të tanishëm nr.08/L-032, i cili tani është në zbatim.

E që kjo qëndron kështu vërtetohet edhe nga Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës Plm. nr. 343/2023 të datës 22.07.2023, i cili është nxjerrë me kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë së Kryeprokurorit të shtetit KMLP.I.nr.11/2023 të dt. 21.06.2023 në dëm të pandehurit, për një rast të tillë, e në të cilin aktgjykim ndër të tjerash është theksuar se i pandehuri gjithëherë duhet merret në pyetje nga prokuroria para ngritjes së aktakuzës, kur për të pandehurin është ngritur aktakuzë për vepra penale ku dënimi është paraparë me dënim me burgim mbi tre vite e më tepër dhe se mos marrja në pyetje dhe mos dhënia e mundësisë së të pandehurit për tu deklaruar në lidhje me veprën penale që i është ngarkuar në procedurë paraprake, bie ndesh me parimet kryesore të procedurës penale dhe parimin e kontradiktoritetin dhe parimin e barazisë së armëve dhe me parimin e mbrojtjes, parime këto që burojnë nga “E drejta për një proces të rregullte” nga neni 6 i KEDNJ-së.

Andaj gjykata duke u bazuar në këto që u tha më lartë, konstatoi se në këtë rast është shkelur parimi i barazisë së palëve në procedurë, pasi që i pandehurit nuk i është marrë në pyetje në seancën e marrjes së deklaratës në procedurë paraprake, nuk është i është dhënë mundësia që

të deklarohet lidhur me aktakuzën e ngritur ndaj tij, nuk i është dhënë mundësia e sfidimit dhe kundërshtimit të provave gjatë fazës së hetimeve, veprime këto procedurale të cilat është dashur që në bazë të dispozitave ligjore të lartcekura të ndermirën para ngritjes së aktakuzës ndaj të pandehurit në rastin konkret pasi që kanë qenë të obligueshme në bazë të ligjit, për shkak se aktakuza ndaj të pandehurit është ngritur për vepër penale ku dënimi është paraparë me dënim me burgim mbi tre vite e më tepër dhe se në këtë rast nga mungesa e këtyre veprimeve hetimore procedurale të detyrueshme kemi edhe mungesë të provave të pranueshme.

Andaj duke u bazuar në këto që u tha më lartë, në bazë të nenit 244 par.1 nën par. 1.5, nenit 462 par. 3 dhe nenit 453 par. 1 të KPPRK-së, gjyqtari i vetëm gjykues, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Nga arsyet e lartcekura, është vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ,
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM-DIVIZIONI PENAL
2023:018385, të dt. 08.01.2025**

**Bashkëpunëtori profesional
Shkelzen Polloviqi**

**Gjyqtari i vetëm gjykues
Imri Sejda**

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi mund të paraqitet ankesë brenda 10 (dhjetë) ditëve nga dita e pranimit të kopjes me shkrim të këtij aktvendimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë. Ankesa i dorëzohet Gjykatës Themelore në Ferizaj.